

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	E Drejta Biznesore dhe Etika
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Semestri:	IV
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lëndë fokusohet në rolin e dispozitave ligjore dhe etikës në suksesin organizativ të biznesit dhe zhvillimin e lidershit. Literatura shkencore e përdorur përfshinë tema mbi të Drejtën biznesore – normat shoqërore dhe burimet juridike, Inteligjenca Artificiale dhe e Drejta Biznesore, Ligjet e ndërlidhura me aktivitetin biznesore, Kontratat, Investimet e Huja Direkte, Pronësia Intelektuale (PI) – llojet e PI, Tregu dhe pronësia intelektuale në BE, Procedurat e Falimentimit, Ri-organizimit dhe Likuidimit të bizneseve, Zgjidhjen jashtë-gjygesore të kontesteve biznesore, Rendësin e aplikimit të Etikes në biznes, Vendimmarrja etike, Korrupsioni dhe transparenca, si dhe tema tjera ndërlidhur me lëndën.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i modulit është që studentet të zhvillohen si liderë ligjërish të aftë të cilët janë në gjendje të përshpejtojnë suksesin në karrierë duke kuptuar aspektet ligjore të përgjegjësi të tyre biznesore, si dhe të tregojnë se si ndërmarrjet duke zbatuar etiken në biznes mund të arrijnë avantazh konkurrues në përputhje me vlerat personale dhe organizative duke përdorur ligjin me përgjegjësi për të krijuar vlerë ekonomike. Ky modul do t'iu mundësojë studentëve shqyrtimin e parimeve themelore ligjore, të situatave të biznesit në Kosovë, si dhe një pasqyrë në të Drejtën Evropiane-ndërkombëtare të Biznesit.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Ndërton aftësi identifikuese të burimeve juridike të drejtës biznesore, (ECTS: 0.60), 2. Kupton rolin e Inteligjencës Artificiale në të Drejtën Biznesore dhe Etiken, (ECTS: 0.40), 3. Përcakton dispozitat ligjore statusore në funksion të drejtës biznesore, (ECTS: 1), 4. Liston mundësitë ligjore për zgjedhjen e kontesteve biznesore dhe për PI, (ECTS: 1), 5. Përshtat normat juridike kontraktore në fushën biznesore dhe përdorimin e Markes, (ECTS: 0.50),

	6. Krijon shkathtësi konceptuale për të marrë vendime etike ligjore për biznesin dhe vlerat personale, (ECTS: 0.50), 7. Aplikon qasjen etike në biznes në kontekst edhe të luftimit të in-formalitetit, (ECTS: 0.40), 8. Demonstron kompetenca bazike për të marrë pjesë në punë ekipore, (ECTS: 0.60),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			35
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjërata do të organizohet duke pas studentin në qendër, do të dëgjohet opinioni i studenteve për literaturën që do të përdoret, për mënyrën e organizimit të ligjërës dhe cila do të jetë e koordinuar me studentet për diskutime interaktive lidhur me temat e ligjërës duke marrë rastet studimi të cilat do të diskutohen në grup, vizitë praktike-grupore me studentë, mësimi duke u bazuar në një problem të paraqitur, angazhim për studentin për të prezantuar njohuritë e fituara gjatë ligjërës dhe prezantimi i punimeve ndërlidhur me materialin e përpunuar.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminari..max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Aktiviteti në mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim		

te nxitjes se debatit gjatë ligjëratave.

- Angazhimi (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese.

Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - te ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - te ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjëratë, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejt të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjësuar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e

	lëndës.....30 pikë (%), ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....40 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i SMART-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. • 88 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 37 orë janë të fokusuara në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 5 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 3.5 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1.5 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Armand Krasniqi – “E Drejta Biznesore”, Prishtinë 2016, 2. Ismail Mehmeti – “E Drejta Biznesore dhe Etika”, Ferizaj 2025 (Ligjëratë e autorizuar), 3. Ymer Havolli – “Etika në Biznes”, Prishtinë 2014,																												
Literatura shtesë	1. Orkida Totojani dhe Enkela Hoxha – “E Drejtë Biznesi”, 2017, Tirane,																												

	2. Oswald, L. & Pagnattaro, M. – “Managing the Legal Nexus Between Intellectual Property and Employees: Domestic and Global Contexts”, Edward Elgar Publishing, Inc. 2015,
<u>Informacion shitesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	*Punimi Shkencor - nga autoret: I. Mehmeti, A. Terstena, H. Krasniqi, A. Bushi dhe G. Deda, me titull – “Legal provisions and the need for adaptation of skills according to the requirements of the labor market in the modern economy – Focus Kosovo”, Prezantuar ne Konferencen Shkencore –“International multidisciplinary scientific research congress”, Sivas Cumhuriyet University, Sivas, Türkiye”, July 04-06, 2025, Proceeding’s book, page 722, ISBN 979-8-89695-107-0 Linku i punimit: https://www.iksadkongre.com/_files/ugd/614b1f_dbb0359da31d4431a5e2fae6167ab5ea.pdf
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, E Drejtën biznesore, Burimet juridike - ligjet dhe aktet tjera nënligjore të ndërlidhura me fushën ekonomike, Është ligjëratë hyrëse, studentet njoftohen me plan-programin e lëndës, zgjedhin grupet punuese për hartim të projekt/punimit, fillohet me ligjëratë gjithëpërfshirëse për të drejtën biznesore si disiplinë shkencore, studentet do të njoftohen me burimet juridike të së drejtës, duke specifikuar burimet primare të së drejtës dhe burimet sekondare, studentet do të njoftohen me normat shoqërore, do të ketë diskutime interaktive me studentët – të cilët do të për zgjedhin temat për punimet që ata do të kryejnë gjatë ciklit të ligjëratave brenda semestrit. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Inteligjenca Artificiale në të Drejtën Biznesore dhe subjektet ekonomike, Ligji për SHT, Parimet ligjore për shoqëritë tregtare dhe llojet e tyre, Në këtë ligjëratë studentet do të njoftohen me rëndësinë që ka fituar Inteligjenca Artificiale ndërlidhur me burimet juridike në të Drejtën Biznesore, pastaj me dispozitat ligjore që e rregullojnë fushën biznesore në Kosovë – konkretisht me Ligjin për shoqëritë tregtare i cili specifikon kush janë subjektet e të drejtës biznesore dhe parimet e funksionit të këtyre shoqërive në Kosovë, diskutim me studentet për propozime eventuale që ata i shohin të arsyeshëm ndërlidhur me lëndën. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2,
Java e tretë	Kontratat dhe të Drejta Biznesore, Investimet e huaja Direkte, Ligji i punës,

	Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime dhe ligjërata, studentet do te njoftohen me dispozitat e Ligjit te punës ne Kosove, me llojet e kontratave biznesore, cila është rëndësia e kontratave ne aktivitetet afariste te bizneseve te regjistruara, kush ka përgjegjësi dhe si zgjidhen kontestet eventuale te cekura ne kontratat biznesore, do te ketë diskutime grupore me studentet për IHD (Investimet e Huaja Direkte), Rezultati i pritur nr. 4.
Java e katërt	Pronësia Intelektuale (marka tregtare, patentat, licencat, e drejta e autorit, modeli i shërbimeve, sekreti tregtare, dizajni industrial, treguesi gjeografik, emrat e domeneve, baza e te dhënave), Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutim me studentet për materialin e ligjëratave paraprake, studentët do te njoftohen me termin Pronësi Intelektuale, pastaj me definimin E drejta e autorit dhe te drejtat e përafërta, si rregullohet kjo fushe me dispozita ligjore, cilat janë benificionet e autoreve te cilët i mbrojnë te drejtat e tyre qe i mundëson ligji për te drejtën e autorit dhe te drejtën e përafërt, studentet do te prezantojnë (diskutim grupor) për aktivitet e tyre punuese, nga studentet do te kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e pestë	Marka tregtare si PI, Tregu dhe pronësia intelektuale ne BE, diskutim grupor për prezantimet nga studentet, Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutime grupore me studente – përsëritje, do te njoftohen studentët me definimin e Markës tregtare, me rëndësin qe ka një Marke për afarizmin tregtar dhe depërtimin ne një treg te synuar, si është e rregulluar me dispozita ligjore kjo fushe ne vendin tone, çka rregullon ligji për Markat tregtare ne vendin tone, pastaj për Tregun dhe PI ne BE, diskutime grupore me studente te cilët do te prezantojnë punimet e tyre, Rezultati i pritur nr. 5.
Java e gjashtë	E drejta e autorit te PI, aktivitet interaktiv me studente për punime, Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me definimin E drejta e autorit dhe te drejtat e përafërta, te cilët i mbrojnë te drejtat e tyre qe i mundëson ligji për te drejtën e autorit dhe te drejtën e përafërt, kush mund ti shfrytëzoj benifitet e ligjit dhe cilat fusha i mbulon, studentet do te prezantojnë punimet dhe do te organizohet diskutim interaktive, Rezultati i pritur nr. 4,
Java e shtatë	Patenta si procese te PI, Tema nga punimi shkencor, Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me Patentën si PI, si rregullohet kjo fushe me dispozita ligjore, cilat janë benificionet e autoreve dhe shpikësve, te cilët i mbrojnë te drejtat e tyre qe i mundëson ligji për patent. Do te ligjërohet bashke me student tema nga

	punimi shkencor. Diskutime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar. Parashihet Testi i parë me shkrim, Rezultati i pritur nr. 4,
Java e tetë	Falimentimi, Ri-organizimi dhe Likuidimi, diskutim grupor (luajtje te rolit nga studentet ndërlidhur me temën) Ne këtë ligjëratë do te ketë diskutim interaktive me fokus përsëritje te ligjëratës paraprake, studentët do te njoftohen me procedurën e Falimentimit, Ri-organizimit dhe Likuidimit, me dispozitat ligjore qe e rregullojnë këtë fushë, fillimi i procedurës se falimentimit, si mund te filloj procedura e falimentimit, si epet mundësia për ri-organizim te subjektit ne falimentim dhe si e parasheh ligji procedurën e likuidimit, studentët do te prezantojnë punimet dhe do te ketë diskutim grupor, nga studentet do te kërkohet mendim për ecurinë e ligjëratave dhe sugjerime eventuale për ndryshim apo përmirësim. Rezultati i pritur nr. 4,
Java e nëntë	Zgjedhja jashtë-gjygsore e kontesteve biznesore, aktivitet grupor me studente (kuiz garues studentor ndërlidhur me temën), Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me dispozitat ligjore qe e rregullojnë fushën për zgjedhjen e kontesteve përmes ndërmjetësimit, negociimit dhe arbitrazhit si mundësi për te gjetur zgjidhje te kontesteve afariste jashtë gjygsore, studentet do te njoftohen si realizohet ndërmjetësimi, negociimi dhe procedura e arbitrazhit ne mes palëve ne kontest dhe si rregullohet kjo qështje me dispozita ligjore, do te ketë aktivitet grupor me studente, Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4,
Java e dhjetë	Etika ne biznes, Respekti, Përgjegjësia dhe Rezultati si detemrinant te suksesit afarist Ne këtë ligjëratë do te ketë përsëritje, studentët do te njoftohen me rëndësin e etikes biznesore, me parimet etike ne biznes dhe pse ato janë te rëndësishme për tu respektuar, do te ketë diskutime grupore – prezantime nga studentet te projekteve te tyre te para-caktuara. Rezultati i pritur nr. 6,
Java e njëmbëdhjetë	Inteligjenca Artificiale dhe Etika ne Biznes, Rregullat dhe procedurat – respektimi dhe ndikimi etik i tyre ne afarizmin biznesor, Ne këtë ligjëratë do te ketë ushtrime- përsëritje, studentet do te njoftohen me rëndësinë qe ka shfrytëzimi i Inteligjencës Artificiale për Etiken ne Biznes, për rëndësinë e zbatimit te rregullave dhe procedurave te parapara për funksionimin e punës ne një biznes, sa janë te rëndësishme vlerat, premtimet dhe zbatimi praktik i tyre, prezantim dhe diskutim grupor me studente, Rezultati i pritur nr. 2 dhe 6,
Java e dymbëdhjetë	Marrja e vendime etike biznesore,

	Ne këtë ligjëratë do të ketë përsëritje – ushtrime ndërlidhur me temat e ligjëruara, studentet do të njoftohen me rendësin e vendimeve etike pre afarizmin biznesor, duke identifikuar vlerat, besimet dhe shpresat për afarizmin biznesor pozitiv dhe vendimmarrje etike, prezantim nga studentet i projekteve hulumtuese, Rezultati i pritur nr. 6,
Java e trembëdhjetë	Pjesëmarrësit biznesor dhe qështjet etike, Ne këtë ligjëratë do të ketë përsëritje, studentet do të njoftohen me rendësin e qasjes etike pre pjesëmarrësit ne biznes siç janë punëtorët, pronaret, menaxhmenti, furnitorët, blerësit, etj, pse lind konflikti ne biznes – arsyet, sa janë te rëndësishme ndershmëria, pa-anësia me qështje etike biznesore, studentet do të prezantojnë punimet e tyre, sipas mundësisë do të shqyrtohet mundësia për te organizuar një vizite pune ne një institucion, kompani apo ne një organizate qe merret me fushën biznesore, Rezultati i pritur nr. 6 dhe 7,
Java e katërbëdhjetë	Korrupsioni dhe origjina e tij, puna grupore, Ne këtë ligjëratë do të ketë përsëritje te temave te ligjëruara, studentët do të njoftohen me termin korrupsion, me nivelin dhe format e korrupsionit, cilat mund te jene pasojat ekonomike te korrupsionit, shkaktaet e rryshfetit si pjese e korrupsionit, do te ketë diskutim grupor me studentet për prezantimet e studenteve. Rezultati i pritur nr. 7 dhe 8.
Java e pesëmbëdhjetë	Transparenca - diskutime interaktive për materialin e lëndës se përpunuar - Testi i dytë me shkrim, Rezultatet e pritura nr. 8
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	